

**UDHËTIMI I GJATË I SHTETIT SHQIPËTAR DREJT
INTEGRIMIT EUROPIAN**

SHQIPËRIA

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT

LIDHJA E KOMBEVE

Gjenevë, 6 Prill 1923



Këshilli i Lidhjes së Kombeve

Përkthyer dhe përgatitur për botim nga Mal Berisha

UDHËTIMI I GJATË I SHTETIT SHQIPËTAR DREJT INTEGRIMIT EUROPIAN

Në Mars të vitit 1923, pas tërë atyre përpjekjeve që shqipëtarët kishin bërë që prej vitit 1912 për krijimin, njohjen dhe ruajtjen e shtetit shqipëtar, Lidhja e Kombeve përgatiti një raport, ku jo vetëm e njihte Shqipërinë si një shtet antar të saj por edhe ku jepte gjithashtu rekomandime për zhvillimin e tij duke nisur një sërë reformash të gjithanëshme të cilat do ta rendisnin Shqipërinë midis kombeve moderne të Europës.

Duke i mundësuar lexuesit tekstin e plotë të raportit të paraqitur nga J.J Sederholm, I lihet atij të gjykojë vetë sesa përparime janë bërë që prej asaj kohe, pra gjatë një periudhe kohore prej 85 vjetësh. Me sa duket, mënyra se si shqiptarët do ta administrojnë shtetin e tyre do të përbënte drojën e shprehur nga J.J. Sederholm, drojë, e cila sot konsiderohet si një ndër pengesat e mëdha në rrugën e gjatë të zhvillimit të shtetit shqipëtar, sigurisht pa lënë pas dore faktorët e jashtëm, të cilët kanë luajtur në të shumtën e rasteve rol parësor. Çuditërisht, ai është treguar mjaft largpamës.

Që nga ajo kohë, shteti shqipëtar ka kaluar nëpër dallgë të mëdha historike. Ardhja e Zogut dhe largimi i tij me dhunë, ardhja e Fan Nolit dhe rrëzimi i tij, rikthimi i Zogut, shpallja e Shqipërisë mbretëri, pushtimi fashist, ardhja e komunizmit dhe sundimi i dorës së hekurt enveristo-staliniste, instalimi i sistemit demokratik pluralist dhe vështirësitë me të cilat u ndesh, të gjitha këto në vija të përgjithëshme përbëjnë tallazet historike nëpër të cilat ka kaluar Shqipëria që prej kohës kur është paraqitur ky raport.

Lexuesi do të ketë mundësinë që të krahasojë rekomandimet e atëherëshme për një Shqipëri moderne me rekomandimet e sotshme të paraqitura nga Bashkimi European për ta futur Shqipërinë në këtë familje të madhe. Cilat janë pengesat do të pyesë dikush? Këtë le ta vlerësojë vetë lexuesi.

Shqipëria pret që së shpejti të bëhet anëtare me të drejta të plota në NATO si dhe të përfundojë procesin e ratifikimit të Marrveshjes së Stabilizim Asocijimit me Bashkimin European.

Lexuesi do të gjejë te ky raport një plan perspektiv të paraqitur 85 vjet më parë dhe që konsiderohet edhe sot si një plan ende i përcaktuar plotësisht. Nëse ne shqiptarët duam të jemi pjesë e Europës, secili duhet të punojë, të luftojë dhe të shfaqë atë dëshirë, vullnet, gatishmëri dhe përkushtim që do na duhet të shfaqim qoftë individualisht, qoftë kolektivisht. E nëse vërtetë duam që atdheu ynë të jetë një vend modern, european, kjo dëshirë fillon dhe mbaron tek kontributi i secilit patriot shqiptar që e do Shqipërinë të tillë.

Mal Berisha

LIDHJA E KOMBEVE

Gjenevë, 6 Prill 1923

SHQIPËRIA

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT

HYRJE: MANDATI I KOMISIONIT

Më 12 Maj 1922, Këshilli i Lidhjes së Kombeve kishte përpara tij një raport të parashtruar prej Komisionit të Shqyrtimit që ishte dërguar në Shqipëri në Nëntor të vitit 1921. Ky raport tregonte se detyra e parë e Komisionit, e cila ishte të vëzhgonte nëse trupat e Shqipërisë dhe Mretërisë serbo-kroato-slllovene të larguara nga zona neutrale e ndërtuar përkohësisht midis shteteve, ishte kryer me sukses apo jo.

Për sa e përket detyrës së dytë, ku do të shqyrtonte dhe do të paraqiste përpara Këshillit masat për t'u dhënë fund turbullirave të tanishme dhe për të parandaluar rishfaqjen e tyre, ky Komision bëri rekomandimet e duhura lidhur me faktin se deri ku do të shtrihej influenca e Lidhjes së Kombeve për sa i përket mbështetjes së saj ndaj Shqipërisë në fushën ekonomike, duke e pajisur qeverinë me ekspertë që do ta ndihmonin atë në kryerjen e reformave të kërkuara për një administrim më të mirë lidhur me zhvillimin ekonomik të vendit, dhe që, në pritje të një vendimi për emërimin e këtyre ekspertëve, një antar i Komisionit duhej të kthehej në Shqipëri për t'i ndjekur ngjarjet nga afër dhe për t'i shqyrtuar këto çështje duke u konsultuar me qeverinë shqipëtare.

Këto rekomandime ishin mbështetur prej qeverisë shqiptare e cila më 25 Mars i dërgoi Këshillit telegramin e mëposhtëm:

“Qeveria shqipëtare e njeh punën e suksesshme të kryer nga Komisioni i Shqyrtimit i cili ka ndihmuar që të largohen rreziqet që kërcënonin paqen në vend. Megjithatë, duke vlerësuar se këto rreziqe ende nuk janë eliminuar tërësisht, ajo beson se do të jetë në interesin e mirëfilltë të Shqipërisë që komisioni të vazhdojë punën e tij për një periudhë të mëtejshme. Prandaj, qeveria shqipëtare i kërkon Këshillit që të ndërmarrë hapat e nevojshme deri sa kjo punë të marrë fund. Për më tepër, qeveria shqipëtare, e bindur se zhvillimi politik varet mbi të gjitha në përparimin ekonomik të vendit, i kërkon Lidhjes së Kombeve që të shtrijë mbështetjen e saj në sferën ekonomike duke emëruar ekspertë që të vijë në Shqipëri, të cilët pasi të kenë bërë hulumtime në terren, të paraqesin propozimet që kanë të bëjnë me hapat që duhen

ndërmarrë për të inkurajuar futjen e kapitalit të huaj në zhvillimin e burimeve natyrore të vendit”

Këshilli i përshtati sugjerimet e bëra ndaj raportit dhe e parashtrori çështjen e ekspertëve teknikë te Komiteti i tij Financiar, i cili kërkoi që një ekspert të kryente një hulumtim të drejtpërdrejtë në vend lidhur me situatën ekonomike të Shqipërisë, dhe bazuar në të dhënat e raportit të tij vendosi që t’i rekomandojë këshillit emërimin e një këshilltari financiar pranë qeverisë shqipëtare. Është e kuptueshme se ky emërim nuk priste dhe se një zotëri i cili do të kishte kualifikimin e domosdoshëm do të vinte shumë shpejt në Shqipëri për të marrë përgjegjësitë e postit të Këshilltarit Financiar pranë qeverisë shqipëtare.

Mua më është kërkuar nga Këshilli që të kthehem në Shqipëri për të vazhduar punën, tashmë të filluar prej Komisionit, në linjat e cekura më sipër. Me mua ishte Konti Frederik Moltke (Nga Danimarka), i cili më zevendësoi verën e kaluar gjatë një periudhe sëmundjeje.

Do të desha të shpreh këtu tërë mirënjohjen time ndaj tij për përkushtimin me të cilin ai iu shtrua një detyrë të tillë të vështirë, dhe të shpreh keqardhje për angazhimet private të paparashikuara të cilat nuk e lanë atë që të punonte me Komisionin deri sa të përpilonim përfundimet e këtij raporti të cilat nuk patën fatin të kishin edhe ndihmën e tij në formulim. Unë dëshiroj gjithashtu që të përfitoj nga ky rast për të shprehur falenderimet e mia të përzemërta ndaj të gjithë atyre me të cilët kam pasur rastin të takohem në Shqipëri. Në mënyrë të pandërprerë kam ndjerë mikpritjen tradicionale të këtij vendi, por ajo për çka unë jam veçanërisht mirënjohës është shpirti i besimit të cilin e kam gjetur si tek zyrtarët shqipëtar ashtu edhe tek njerëzit e thjeshtë të cilët më është dhënë mundësia t’i takoj gjatë misionit tim. Pa këtë shpirt besimi puna ime do të kishte qenë e vështirë dhe e pafrytshme.

Nëse më lejohet që të shpreh një dëshirë, ajo është: “Ata të cilët kanë shfaqur besim tek unë në Shqipëri duhet ta dijnë, se besimi që patën tek unë nuk ka shkuar kot dhe po ashtu duhet ta kuptojnë se kritikizmi që kam ndjerë si detyrë ta vë në raport nuk ka pasur tjetër motiv përveç dëshirës time më të sigurtë për t’i shërbyer Shqipërisë.”

Unë në raporte të ndryshme kam vënë në pah, progresin e kryer dhe në pika të ndryshme kam paraqitur rekomandime të përcaktuara - veçanërisht lidhur me situatën në Jug të Shqipërisë - si edhe masat që duhen marrë për të bërë një përparim të mëtejshëm.

SITUATA NDËRKOMBËTARE E SHQIPËRISË.

Në raportet paraprake është vënë në pah se mardhëniet e jashtme të Shqipërisë, shkak fillestar i ndërhyrjes së Lidhjes së Kombeve në çështjet e saj, janë përmirësuar si rezultat i kësaj ndërhyrje në masë shumë të madhe, dhe sot, mund të themi me plot gojën se ato janë plotësisht të kënaqëshme. Tani egzistojnë disa çështje shumë të

rëndësishme midis Shqipërisë dhe fqinjëve të saj, të cilat mund të shfaqen herë pas here dhe mund të çenojnë marrëdhëniet e mira që janë vendosur. Ajo ka shkëmbyer tashmë perfaqësi diplomatike me to, sikundër edhe me shumë shtete tjera. Kufinj të saj janë përcaktuar, me përjashtim të disa sektorëve të vegjël të cilët, edhe ata, do të përcaktohen në këtë pranverë. Përfaqësuesit e ngarkuar të Fuqive Fqinje kanë deklaruar publikisht qëllimin dhe dëshirën e tyre për të mbajtur marrëdhënie të përzemërta me shtetin e ri shqiptar si dhe të respektojnë pavarësinë dhe integritetin e tij.

Përsa i përket politikës së jashtme, që duhet të ndjekë Shqipëria, vëzhgimet njëvjeçare kanë konfirmuar mendimin e dhënë prej Komisionit në raportin e tij të përgjithshëm në Maj të vitit 1922:

“ E thënë shkurt, Shqipëria duhet të orvatet që të përmbahet sa më shumë të jetë e mundur nga ndonjë politikë aktive e jashtme. Ajo që është thelbësore për të është se ajo duhet të gëzojë paanshmëri të plotë me qëllim që t’i përkushtohet tërësisht zhvillimeve të saj kushtetuese, ekonomike dhe sociale.”

SITUATA E BRENDSHME.

Vlerësime të përgjithshme.

Tani më lejoni të vij tek ajo që e quaj pjesën më të rëndësishme të vlerësimeve dhe rekomandimeve që më duhet të paraqes.

Marrëdhëniet e jashtme të Shqipërisë mund të pritët që, me ndihmën e Lidhjes, të mbeten të mira duke shpresuar se ajo do të mbajë një qëndrim të vendosur asnjëherë dhe veçanërisht po të kihet parasysh se ajo do të mund të vendosë rregull brenda vendit.

Nëse situata e brendshme e vendit bëhet kaotike, ajo në mënyrë të pashmangshme do të ketë efekt në marrëdhëniet e vendit me fqinjët. Detyra më e rëndësishme e shqipëtarëve dhe e qeverisë së tyre është që të sigurojnë një ndjenjë solidariteti midis pjesëve të ndryshme të popullatës, të zhvillojnë burimet ekonomike të vendit, të ndërtojnë një sistem modern ligjor dhe të inkurajojnë ndërtimin, aq sa e lejon ekonomia, të një themeli kulturor dhe edukativ.

Shqipëria e ka arritur pavarësinë në një kohë kur e tërë bota është e varfër, prandaj ajo e gjen veten në disavantazh po të krahasohet me situatat në të cilat u gjetën shtetet tjera ballkanike kur ia dolën të fitonin pavarësinë. Shtetet tjera, në përgjithësi, gjetën ndonjë fuqi të madhe të gatshme për t’u miqësuar me to duke iu ofruar edhe ndihmë ekonomike.

Shqipëria varet nga Lidhja në mbështetjen politike të dhënë në mënyrë të paanëshme dhe nuk ka për t’u ballafaquar me dallime, por përsa i përket ndihmës financiare ajo duhet që tani për tani ta gjejë vetveten në tregun financiar në një sasi të vogël të favorshme që ofron

mundësitë e tregtisë fitimprurëse ndaj investitorëve dhe dhënien e garancive ligjore të zakonshme të një shteti modern e të qeverisur mirë.

Fakti, që ne nuk mund të themi sot se Shqipëria është një shtet modern dhe i mirëqeverisur, nuk përbën domosdoshmërisht një verëjtje për të.

Edhe Shqipëria, si të gjitha shtetet tjera ballkanike në të kaluarën, e gjen veten e saj, në momentin e fitores së pavarësisë, në një situatë afërsisht si kjo e përshkruar më poshtë:

“Ajo e gjen veten me sistem të pamjaftueshëm rrugor, arsimor; pa një administratë efektive, pa një legjislacion modern; për shkak të mos lejimit të përdorimit të gjuhës amtare në të kaluarën, ajo e gjen veten në kondita të papërshtatshme gjuhësore. Njerëzve të saj iu është bërë zakon të dyshojnë ndaj autoriteteve të cilat në të kaluarën shpesh janë vënë në shërbim të huaj.

Malësorët janë mësuar që ta bëjnë ligjin vetë, t’i shmangen taksave dhe shërbimit ushtarak dhe të mbajnë armë për të mbrojtur vetveten. Disa pjesë të vendit janë ende në një shkallë zhvillimi të njëjtë me atë të Europës Perëndimore në Mesjetë.”

Përmirësimi i situatës së brendshme.

Une jam i lumtur që më jepet mundësia të deklaroj se ka një përmirësim dhe stabilizim të situatës së brendshme që prej vitit të kaluar. Qeveria, nën udhëheqjen energjike dhe të aftë të udhëheqësit të ri Ahmet Bej Zogu, i cili ka ushtruar një influencë mbizotëruese gjatë kësaj periudhe, duke qenë në krye të saj që nga nëntori i vitit të kaluar, e shtypi lehtësisht të vetmen kryengritje të organizuar në vend. Në Janar, udhëheqësit famëkëqinj të bandave, Bajram Curri dhe Mustafa Kruja, të ndihmuar prej një numri të madh malësorësh shqipëtarë dhe refugjatë nga Rajoni i Kosovës prej Mbretërisë serbo-kroato-slllovene qenë mbledhur në një zonë asnjënjë midis dy vendeve, e cila tani fatmirësisht nuk ekziston më, dhe, në fillim ja dolën që t’i habitnin njerëzit duke e marrë qytetin e vogël të Krumës në Malësi, si edhe Shtabin e Nënprefekturës por lëvizja u vu shpejt nën kontroll prej trupave qeveritare me shumë pak gjakderdhje.

Është kryer edhe ç’armatimi i popullatës në të gjithë vendin ndonëse ka ende dyshime për armë të fshehura. Zakoni i mbajtjes së armëve, gjë që është e ndaluar me ligj, praktikisht ka pushuar së qeni.

Gjakmarrja, nëpër malet e veriut po shuhet me shpejtësi, ashtu si edhe vjedhja, e cila më parë në disa rajone të jugut të Shqipërisë ishte një formë e rregullt e jetesës. Popullsia i është përveshur punëve të bujqësisë dhe punëve të tjera që bëhen në kohë paqe.

Për herë të parë ndër shekuj, një qeveri ka marrë në dorë fuqi të pakundërshtuar në të gjithë territorin e Shqipërisë duke qenë e aftë që të thërrasë për rekrutim dhe të mbledhë taksa madje edhe në zona të

largëta nëpër male, ku popullsia gjatë regjimit turk jetonte në një gjendje praktikisht të pavarur.

Duhet thënë në mënyrën më të ndershme se faktet që u numëruan më lart, siç janë ç'armatimi, rënja e nivelit të gjakmarrjes dhe mbledhja e taksave, janë prova të dukshme që flasin në favor të arritjes në përfundimin se në Shqipëri kanë filluar të hidhen bazat e një shteti modern me rend të forcuar. Duhet thënë gjithashtu se i duhet bërë thirrje me të madhe patriotizmit të shqiptarëve nëse ata duan që të zhvillojnë një standard civilizimi si ai që kërkon një shtet modern; nëse ata duan që të tërheqin kapitalin e huaj, atyre iu duhet të shfaqin shpirt besimi në institucionet e tyre dhe në stabilitetin e vendit.

Duke rrezikuar që të prek ndjenjat e ndokujt, prapëseprapë nuk rri dot pa deklaruar se e ndjej për detyrë që të shpreh rezervat e mija për shumë prej mangësive që duhet të korrigjohen dhe të tregoj deri në një farë mase se si mund të shërohen ato.

Problemet kushtetuese.

Megjithëse, siç është thënë tashmë, qeveria e sotshme shqipëtare ka përcaktuar që të ndjekë një linjë reformash, tani për tani ka pak njerëz me përvojë dhe cilësi personale të nevojshme për t'i vënë në zbatim ato, në jetën publike të vendit. Për më tepër, krijimi i qeverisë së sotshme erdhi më shumë si rezultat i një situatë të jashtëzakonshme. Ajo u formua fill pas ngjarjeve të caktuara revolucionare që kishin ndodhur, dhe parlamenti i dha qeverisë fuqi të veçanta që të mbante rendin si rezultat i së cilave njerëz të caktuar me influencë janë ende në mërgim.

Shqipëria, sipas Kushtetutës së Përkohshme të Lushnjës, ka një regjim parlamentar dhe një këshill të përbërë prej katër antarësh të cilëve iu është besuar fuqia supreme; megjithatë, ka një pushtet real në duart e qeverisë. Nuk është krejt e qartë se çfarë regjimi do të adaptohet kur të vijë koha për të ndërruar kushtetutën e tanishme të përkohëshme.

Egziston mundësia që vjeshtën e ardhëshme të mblidhet një asamble kushtetuese për të diskutuar për formën e përhershme kushtetuese, por nuk është e sigurtë nëse ka ardhur ende koha për të vendosur mbi këtë çështje kaq komplekse.

Parlamentarizmi në kuptimin e vërtetë perëndimor të fjalës, me votim të përgjithshëm të drejtpërdrejtë nuk duket se i shkon aq mire për shtat Shqipërisë së sotshme me atë popullsi heterogjene që përbëhet nga një shumicë analfabete dhe ku në rajone mjaft të gjëra të së cilës gjendet ende e përhapur një formë feudalizmi. Është e domosdoshme që të ketë një qeveri qëndrore të fuqishme, duke iu dhënë pjesëve të ndryshme të vendit fuqi të caktuar administrative vendore. Gjetja e duhur e një barazpeshe midis centralizimit dhe decentralizimit do të ishte një ndër detyrat më të rëndësishme që do t'i vihej përpara një burri-shteti shqiptar.

MARRDHËNIET MIDIS ELEMENTËVE TË NDRYSHËM TË POPULLSISË.

Ndikimi i ngjarjeve të fundit në Lindjen e Mesme.

Në kohën kur po shkruhej raporti i përgjithshëm i Komsionit për takimin e këshillit, i parashikuar për në Maj të vitit 1922, dukej se kryengritjet e fiseve në Malësi apo në Shqipërinë Qendrore të drejtuara prej kryefeudalëve të tyre ose prej aventurierëve politikë që i shërbenin vetëm interesave dhe rivaliteteve personale, ishin kërcënimi më i madh që rrezikonte zhvillimin e qetë të vendit. Mendoj se mbasi e kam studiuar politikën e brendshme të Shqipërisë për mëse një vit, ky rrezik është po aq i madh sa ç'ishte menduar. Nëse nuk paguhen para për njerëz të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në aventura të tilla, atëherë përsëritja e tyre do të vinte duke u ulur dhe kështu do të ishte e lehtë për qeverinë që t'i nënshtronte ata me ndihmën e një xhandarmërie të përgatitur.

Për mendimin tim, vështirësia më e madhe për Shqipërinë është, shumëllojshmëria e qëllimeve dhe interesave të cilat ende ekzistojnë midis elementëve të popullsisë së saj që ndahet prej qëllimeve fetare.

Për të qenë të hapur, në raportet e mëparshme ne kemi nënvizuar faktin që fanatizmi ekziston midis popullsisë muslimane të Shqipërisë në një masë më të ulët ndoshta se në ndonjë vend tjetër të botës me popullsi dominuese muslimane. Shumë shenja tregojnë se muslimanët dhe të krishterët ishin gati që të harronin mospajtimet, të cilat patën ekzistuar në të kaluarën, dhe të bashkonin përpjekjet me qëllim që të zhvillonin një kulturë të vërtetë shqipëtare. Megjithatë, siç kam thënë në raportin tim mbi kushtet në jug të vendit, tani atje vihet re një divergjencë më e madhe midis të krishterëve dhe muslimanëve se sa vihej re një vit më parë dhe e njëjta gjë paraqitet në një shkallë më të ulët në popullsinë e veriut ku, megjithatë, nacionalizmi shqiptar është shumë i fortë edhe midis të krishterëve.

Ngjarjet e rëndësishme në Lindjen e Mesme e kanë shtrirë hijen e tyre edhe mbi Shqipërinë. Një numër i madh, ndoshta shumica e oficerëve dhe zyrtarëve shqipëtarë, kanë qenë më parë në shërbimin turk. Shumica e tyre i kanë marrë mësimet e para dhe i kanë lexuar gazetatat në gjuhën turke kur u festua fitorja e Turqisë moderne. Nuk ka dyshim se kjo valë e ngritjes së vetëdijes i ka gjallëruar deri në një farë mase ndjenjat e shqiptarëve muslimanë ndërsa nga ana tjetër ka shkaktuar ndruajtje serioze ndaj patriotëve të tyre të krishterë.

Shqiptarët muslimanë, ishin të parët që i kundërshtuan me vendosmëri metodat qendërsuese të "Turqve të Rinj" si dhe pan-islamizmin, për shkak se të dyja këto u mohonin shqipëtarëve të drejtat për t'u ndarë nga Turqia. Tani që është thënë se besimi në dogmën islame është në pajtim me nacionalizmin në kuptimin modern të fjalës, nacionalistët muslimanë shqipëtarë mund të jenë të prirur të kërkojnë zhvillimin e ardhshëm të Shqipërisë kryesisht në Lindje dhe ndoshta të

përpiqen që të ruajnë ish – supermacinë e muslimanëve mbi patriotët e tyre të krishterë.

Rezultati fillestar i ringjalljes së muhamedanëve në Shqipëri mund të jetë një ndjenjë në rritje e vetësigurisë së cila, ndërsa mbetet e pajtueshme me patriotizmin shqiptar mund t'i japë asaj një karakter më të veçantë muhamedan se nga ç'e kishte një vit më parë dhe t'i largojë kështu muhamedanët dhe të krishterët prej njëri tjetrit. Kjo ka shkaktuar tashmë dyshime të forta midis të krishterëve, dhe këto ndjenja përbëjnë në vetvete një rrezik.

Çështja nuk është krejtësisht fetare pasi nuk mund të thuhet se në anën e muslimanëve, në çfarëdo rasti ekziston ndonjë fanatizëm i cili të shkojë aq larg sa të merret në konsideratë. Prova më e mirë për këtë është programi i reformave që po diskutohet tani në Tiranë nga ana e një Kongresi Muslimanësh i cili duket të jetë i një karakteri thellësisht liberal. Është thënë t'i jipet fund poligamisë; të përmirësohet gjendja e gruas, si dhe të bëhen reforma të tjera të cilat kanë ndikim të madh social. Këtu kemi të bëjmë më shumë me çështje të ndjenjave klasore, muhamedanët pronarë të tokave dhe, klasa e zyrtarëve duke pasur të trashëguar prej së kaluarës një ndjenjë superioriteti ndaj të krishterëve, gjë që këta të fundit duket të mos e pëlqejnë dhe shpresojnë ta shohin të zhdukur në një Shqipëri të pavarur. Një vit më parë kjo ndjenjë ishte në rënie dhe ringjallja e tashme mund të jetë vetëm e përkohëshme dhe sipërfaqësore. Siç do ta shohim edhe më vonë, qeveria e ka kuptuar rrezikun dhe e ka pasqyruar këtë në programin e saj.

Të krishterët e Shqipërisë nuk do të ishin të kënaqur me një sistem prej të cilit ata do të shiheshin si një minoritet i toleruar që jeton nën hijen e një shumice me qëllime të ndryshme. Është e vërtetë se të krishterët janë dukshëm më pak nga ana numerike, duke përbërë më pak se 30% të të gjithë popullsisë por nisur nga të qenurit ekonomik dhe nga pasuria, si dhe nisur nga kultura e tyre, ata janë thuajse aspak më të parëndësishëm nga shumica muslimane. Madje duket të jetë pikë e debatueshme nëse në Shqipëri ka ndonjë fe e cila është mbizotëruese ndaj tjerave. Në qoftë se bektashinjtë e jugut, të cilët numërojnë rreth dyqint mijë besimtarë, do të njiheshin si fe e ndryshme sikundër thonë disa se duhet të njihen, atëherë sunitë nuk do të zotëronin ndonjë shumicë absolute.

Për sa i përket marrdhënieve me vendet tjera, të krishterët e Shqipërisë do të luanin një rol të pazëvendësueshëm. Tendencia e këtij vendi është drejt perëndimit dhe me zhvillimin ekonomik dhe kulturor lidhjet e tij me Perëndimin do të jenë gjithnjë e më të ngushta. Fqinjët më të afërt në jug dhe në lindje janë vende të cilat mbajnë fenë e krishterë, ndonëse një pakicë e vogël besojnë në fenë muslimane. Shqipëria është një ndër vendet më të vogla në Europë dhe ka nevojë të jashtëzakonshme për bashkëpunimin e të gjithë qytetarëve të vet. I vetmi program politik i cili i bashkon të gjithë shqiptarët është ai i reformave të thella dhe të mençura. Qeveria aktuale dhe në mënyrë të veçantë kryeministri janë të

njohur mirë me këtë nevojë dhe unë jam i lumtur që më jepet mundësia që të deklaroj se shumica e reformave që mbroj këtu janë të pranishme në programin e qeverisë.

PROGRAMI I QEVERISË SË SOTME

Në fjalimin e tij në parlament më datën 2 Dhjetor 1922, kryetari i porsazgjedhur Ahmet Bej Zogu bëri një paraqitje të politikës së tij e cila përmban pikat e mëposhtme: Qeveria ka si qëllim që t'i shkojë një rruge demokratike e konstitucionale. Ajo është në favor të lirisë së shtypit. Ajo njih vështirësitë që ekzistojnë prej tre elementëve të popullatës me standarte të ndryshme të kulturës, jugorët - më të zhvilluar në njohjen dhe interesat për çështjet publike - por shpreson se ai do të fitojë besimin e të gjithë elementëve të ndryshëm dukë u marrë ndershmërisht me to dhe duke i dhënë secilës palë të drejtën që të shkojë në drejtimin e aspiratave të veta. Suksesi i ka shoqëruar tashmë përpjekjet e bëra për të organizuar Kishën Ortodokse dhe qeveria do të përpiqet të inkurajojë një administratë moderne të klerit muhamedan të Shqipërisë. Qeveria shpreson që në shtator të thërrasë një Asamble Kushtetuese dhe premton që të mbajë qëndrim asnjë në zgjedhje. Fondi i ndarë nga buxheti për të luftuar malarjen dhe sëmundje të tjera është dyfishuar dhe ekspertët do të merren nga jashtë që të ndihmojnë që të luftohen këto sëmundje. Buxheti është shkurtuar, numri i nënpunësve është zvogëluar, dhe ka filluar riorganizimi i administratës. Prefektët duhet të emërohen bazuar në përvojën e tyre lidhur me rajonet të cilët ata emërohen. Një ekspert ligjor i cili të njohë mirë gjyqet dhe legjislacionin duhet që të merret nga jashtë. Ushtria duhet zvogëluar sa më shumë të jetë e mundur dhe të emërohet një instruktor i huaj.

Punëve publike duhet t'u kushtohet vëmendje më e madhe. Me qëllim që të shpejtohet ndërtimi dhe përmirësimi i rrugëve duhet që të mobilizohen tre batalione rekrutësh, në vend të një batalioni që kishte në të kaluarën. Plani i pritshëm për vitin 1923 është zvogëluar në mënyrë drastike dhe tani përlllogarit vetëm 17 milionë franga ari.

Pritej që të mblidhej një e ardhur prej 19 milionësh e cila do të linte një shumë prej 2 milionësh për punët publike. Mësimet publike duhet të zhvillohen mbi baza kombëtare me ndihmën e një eksperti të huaj. Por përpara së gjithave, qeveria duhet të përpiqet që të zhvillojë tregtinë në vend, ngecja e zhvillimit të së cilës është shkak i zemërimit të një pjese të mirë të popullsisë. Qeveria shpreson se do të jetë në gjendje që të tërheqë kapitalin e huaj në Shqipëri si dhe të ketë Këshilltarin e Financave të emëruar sa më shpejt nga Lidhja e Kombeve.

Për sa i përket politikave të jashtme, qeveria do të ndjekë një politikë të shtrënguar asnjëse dhe do të përpiqet të mbajë mardhënie miqësore me vendet fqinjë si dhe kontakte të afërta me Lidhjen e Kombeve së cilës Shqipëria i detyrohet aq shumë.

Qeveria shqiptare ka shprehur në mënyrë të përsëritur dëshirën e madhe për të siguruar shërbimin e Këshilltarit Financiar të emëruar prej Lidhjes së Kombeve i cili do ta ndihmojë atë që të zbatojë programin e sipërpërmendur dhe të ndihmojë që të ndërmerren reforma prej të cilave varet mirëqenia e Shqipërisë. Është vendosur tashmë, siç është thënë, që të emërohen ekspertë tjerë të huaj për drejtësinë, xhandarmërinë, arsimin, punët botore, shëndetësinë dhe ndoshta më pas edhe për shërbimë të tjera.

Duket e këshillueshme që këta ekspertë të emërohen pas konsultimeve me Këshilltarin Financiar të cilit i duhet që të bëjë përgatitjet për paratë e nevojshme si dhe për pagesat dhe zbatimin e planit që ata do të rekomandojnë.

BURIMET E SHQIPËRISË

Përpara se sa të vij tek kapitulli i fundit i këtij raporti që merret me të tilla rekomandime të përgjithshme, unë e konsideroj si detyrën time që të tërheq vemëndjen ndaj raportit të kryer për Komitetin e Financave të Lidhjes së Kombeve nga Profesor Kalmes (Calmes) dhe të përqëndrohem në pika të caktuara.

I përket zhvillimit të burimeve të saj ekonomike që Shqipëria të përftojë pasuritë e domosdoshme për të nisur programin social i cili do ta bënte popullin shqipëtar një popull me një shtet që vepron në bazë të inisiativave të koordinuara.

Është thënë tashmë që Shqipëria zotëron burime ekonomike të mjaftueshme për të vendosur bazat e ekonomisë kombëtare të një shteti të pavarur.

Duket se në përgjithësi mbretëron mendimi se Shqipëria është një vend i cili përbëhet kryesisht nga male të shkreta njësoj si ato të rajonit "Karst" në bregdetin Dalmat. Kjo nuk është e vërtetë; në më të shumtën e sipërfaqes, malet e Shqipërisë janë të mbuluara me dhe, dhe për rrjedhojë edhe me pemë e shkurre. Përgjatë bregdetit dhe në rrëpirat midis vargmaleve ka hapsira me zona pjellore, përgjithësisht me një klimë të ngrohtë dhe reshje të mjaftueshme.

Është provuar prania e serës në gjendje të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë, por a janë të mjaftueshme rezervat e naftës apo jo, për një shfrytëzim afatgjatë, kjo mbetet të shihet nga rezultatet e punëve kërkimore të cilat janë shumë të shtrenjta.

Qymyri që gjëndet në Korçë, Tepelenë etj, sigurisht që meriton vëmendje më të madhe për shkak të rëndësisë që ka për perspektivën e industrisë, veçanërisht për shfrytëzimin e mineraleve, nëse gjënden të tilla në sasi të mjaftueshme në Luginën e Vjosës apo gjetkë. Sasitë e mëdha të piritëve të hekurit në malet e Veriut të Shqipërisë meritojnë shumë vëmendje, për shkak të përmbajtjes së tyre sulfurike dhe për shkak se ato duket të jenë, siç ndodh zakonisht në raste të tilla, të lidhura me minerale bakri. Në përgjithësi të gjitha këto pjesë të maleve të

Shqipërisë ku shkëmbinjtë e njohur si të përthyer meritojnë shumë vëmendje prej kërkuesve të mineraleve. Mineralet e bakrit, hekurit dhe kromit gjenden pa dyshim ndërkohë që priten edhe zbulime të reja.

Prapë se prapë duhet të theksohet se, si rregull i përgjithshëm, burime të tilla minerare janë ende në fazën e zbulimit dhe se shtrirja dhe sasia e tyre është ende e panjohur. Megjithatë do të duhen vite derisa industria minerare të krijohet në Shqipëri.

Përdorimi i energjisë ujore e cila gjëndet me bollëk varet nga gjetja e mënyrave të përshtatshme për ta shfrytëzuar atë. Kjo pa dyshim mund të përdoret me fitim për prodhim të energjisë elektrike, për ndriçim dhe përdorim për qëllime lokale, por zhvillimi i tyre për përdorim industrial në një shkallë të gjërë do të varet në përmirësimin e komunikimit dhe praninë e sasive të mjaftueshme të lëndëve të para.

Pyjet, më së shumti lis dhe pishë, mund të jenë burim i të ardhurave, por në të ardhmen Shqipërisë do t'i nevojiten të gjitha burimet e saj në dru, dhe do të ishte e domosdoshme për të nxitur pyllëzimin në malet, të cilat tani po vuajnë nga shkatërrimi i çobanëve të dhive.

Derisa kërkimet e mëtejshme të jenë bërë brenda shtrirjes dhe vlerave ekonomike të burimeve të saj minerare, duke përfshirë qymyrin dhe naftën, është mendimi i shumë vëzhguesve kompetent që pasuria më e madhe e Shqipërisë qëndron në tokën e saj pjellore.

Metodat e kultivimit janë primitive dhe joproduuese. Megjithatë, pjellshmëria e tokës dhe klima e mirë japin mundësi për kultivimin e drithërave siç janë misri dhe gruri, i frutave si rrushi, ullinjtë, portokallet, fiqtë, bajamet, arrat dhe pemë të tjera, krimbi i mëndafshit që mbarështrohet në drurët e manit të zi dhe mbi të gjitha, mund të prodhohet një cilësi shumë e lartë e duhanit. Mendohet se edhe pambuku mund të rritet në jug.

Shqipëria ka zona të tëra tokash pjellore, për momentin ose të pakultivuara fare ose të kultivuara në mënyrë të papërshtatshme siç është Myzeqeja afër Beratit, një zonë shumë e gjerë me një klimë të ngrohtë dhe me tokë të zezë e të pasur por tani për tani moçalore. Pronësia mbi këtë tokë në një masë të madhe është e shtetit. Gjithashtu ka zona të tëra me tokë të mirë edhe përgjatë brigjeve detare edhe paralel me to, ndonëse të ndara prej kodrash.

Pengesa kryesore ndaj zhvillimit të këtyre zonave është prania e malarjes, por as kjo dhe as karakteri moçalor i pjesës më të madhe të tokës së vlefshme që tani për tani kultivohet në mënyrë të papërshtatshme nuk paraqesin pengesë të pakapërcyeshme ose të bëjnë të domosdoshme shumë shpenzime të konsiderueshme.

Përveç atyre që u thanë më lart ka zona të cilat janë tërësisht moçalore por që mund të thahen me një kosto të madhe por jo të papërballueshme. Edhe këto shtrihen përgjatë bregdetit.

Është gjithashtu edhe Liqeni i Maliqit në Korçë, tharja e të cilit nuk do të ishte aq e kushtueshme. Një projekt tjetër i rëndësishëm dhe me

fitim është disiplinimi i Lumit Buna nëpërmjet të cilit dalin në det ujrat e Liqenit të Shkodrës si dhe pjesa e ultësirës së Lumit Drin në të njëjtin rajon. Rregullimi i këtyre lumenjve do ta shpëtonte Liqenin e Shkodrës nga mbushja e tepërt dhe do të lejonte lirimin e shumë tokave pjellore edhe në Shqipëri dhe veçanërisht në territorin serbo-kroato-sllloven. Kjo do të lëshonte mjaft tokë pjellore sa për të furnizuar me drithëra të mjaftueshme popullsinë në të dyja anët e kufirit.

Sistemimi i Lumit Buna do të rigjallëronte rëndësinë tregtare të qytetit të Shkodrës në të cilin edhe tani shkarkohen anije të vogla dhe që do të bëhej, siç ishte në të kaluarën, një port i rëndësishëm që ju shërben dy vendeve.

Lirimi dhe vënia në prodhim e kësaj sipërfaqje të madhe toke do të jepte mundësinë e kultivimit të një sasive më të madhe drithërash dhe frutash të përshkruara, por mbi të gjitha, të duhanit. Industria e duhanit mund të bëhet një prej burimeve kryesore të të ardhurave të vendit, mbasi toka dhe klima në vetvete japin mundësinë e kultivimit të duhanit dhe cigareve me cilësi nga më të lartat.

Përveç kësaj do të kishte efekt social, zhvillimi i zonave kaq shumë të përshtatshme për krijimin e një bashkësie bujqësore të begatshme. Kjo do të shuante urinë e madhe që egziston sot për tokë dhe do të ndihmonte në zhvillimin e metodave moderne të kultivimit bujqësor. Ky do të ishte një burim të ardhurash të begatshme për qeverinë si dhe burim mirëqenieje duke i dhënë përparësi investitorëve të cilët do të josheshin prej mundësive të reja.

Fermtat model dhe shkollat bujqësore do të nxisnin dhënie kompanive të huaja të konçensioneve të mundëshme mbi tokën. Qeveria tani po e sheh me përparësi këtë çështje dhe do të ishte një ndër detyrat më të rëndësishme të Këshilltarit Financiar dhe ndonjë ekspert tjetër që mund të emërohet për të ndihmuar qeverinë që të ndjekë një politikë progresive në këtë çështje.

PËRFUNDIM

Qeveria, nëpërmjet kryeministrit të vet, ka shprehur vendosmërinë e saj që t'i japë njëzëri këshilltarit ekspert propozimet për punësimet dhe në mënyrë të veçantë Këshilltarit Financiar, një autoritet që është i domosdoshëm nëse ata duan që vërtetë t'i shërbejnë Shqipërisë. Pa i dhënë një karakter të tillë, puna e këtij eksperti, të paktën siç është vepruar deri tani, do të ishte e barabartë me zero.

Në punën për ndërtimin e një administrate moderne, në mënyrë të pashmangshme do të dalin vështirësi që kanë të bëjnë me zyrtarët e mësuar me metoda të vjetra që e pengojnë punën e së ardhmes. Kjo do të kërkojë shumë vendosmëri dhe takt nga ana e Qeverisë, Këshilltarit Financiar dhe ekspertëve tjerë nëse duan që puna thelbësore e riorganizimit të kryhet duke i tejkalluar interesat e atyre që e kundërshtojnë atë.

Një përplasje e tillë mund të shmanget nëse në krye të punëve vihen patriotët, njerëzit që veprojnë jo për interesat e tyre të ngushta por për interesat e shtetit, udhëheqësit e vertetë të zgjedhur dhe të besuar nga populli. Po a mund të ndodhë e kundërta? Kjo duhet tejkaluar me çdo kusht. E ardhmja e Shqipërisë varet tek ajo vetë. Shqipërisë i duhet në mënyrë urgjente kapitali i huaj nëse do që të zhvillojë burimet e saj ekonomike. Asaj i nevojitet një bankë që shtyp para, banka tregtare dhe ajo bujqësore. Gjithashtu duhet shpresuar që kapitali i huaj të interesohet për zhvillimin e bujqësisë së saj, për shfrytëzimin e mineraleve dhe burimeve tjera. Nuk duhet shpresuar që parellinjtë e ndershëm dhe të përgjegjshëm t'i rrezikojnë paratë e tyre në Shqipëri deri sa aty të gjejnë një administratë publike të aftë e kompetente me të cilën të mund të bashkëpunojnë.

Sistemi ligjor duhet të jetë në një nivel me standartet moderne dhe të funksionojë në mënyrë efikase dhe të ndershme. Duhet siguruar qetësia publike. Duhet që punonjësve të tërë vendit, që janë të gatshëm për të punuar dhe mësuar, t'u krijohen mundësitë për këtë.

Të gjitha këto janë të mundura nëse qëllimi i shqiptarëve është i nxitur nga një motiv i qartë dhe i fortë për zhvillimin e vendit të tyre. Nëse, për një arsye apo një tjetër, ky motiv dhe forca e nevojshme e dëshirës që e shtyn atë përpara nuk manifestohen ashtu siç duhet, atëherë Shqipëria do të bëjë vendnumëro. Një ngecje e tillë do përbente rrezikun më të madh ndaj ruajtjes së pavarësisë së vendit. Shqipëria, gjeografikisht është në Europë. Ajo duhet të marrë pjesë në rrjedhat ekonomike të saj. Nëse udhëheqësit e saj të tanishëm tregojnë se janë të papërshtatshëm ndaj detyrave që kanë marrë, atëherë, siç na mëson historia, në mënyrë të pashmangshme ata do të zevendësohen nga regjim tjetër.

Unë jam i bindur se këto detyra nuk janë të paarritshme po të kemi parasysh patriotizmin dhe aftësitë e racës shqiptare. Kurdo që shqiptarëve iu është dhënë rasti, ata kanë bërë atë që duhet, madje edhe më shumë, por në dhera të huaja. Ka qenë fati i tyre i keq që ata asnjëherë nuk kanë arritur që të tregojnë cilësitë e tyre, në atdheun e tyre. Tani iu ka ardhur rasti tek dera. Për herë të parë, Shqipëria është një vend sovran dhe i pavarur. Ajo është në paqe me fqinjët. Tani ajo është anëtare e Lidhjes së Kombeve marëveshja me të cilën e bën atë që të jetë nën mbrojtjen e saj si çdo anëtar tjetër. Megjithatë, ajo duhet të vendosë paqë në shtëpinë e vet ose përndryshe edhe kjo mbrojtje do të provohet se është e kotë. Europa nuk mund të lejojë që ndonjë pjesë e kontinentit të saj të mbetet në mënyrë të vazhdueshme në gjendjen e një prapambetjeje të thellë.

Shqipëria tani i ka mundësitë që të shfrytëzojë aftësitë e këshilltarëve të zotë dhe pa interesa. Nëse ajo, sinqerisht ua dëgjon këshillat atyre, dhe nëse njerëzit e saj punojnë, nuk ka arsye përse Shqipëria të mos e arrijë kohën që ka humbur, jo për faj të saj. Raca

është një pasuri e madhe, por tani për tani asaj i mungon përvoja dhe dijenia.

Fati i Shqipërisë gjëndet në duart e njerëzve të saj si dhe në aftësinë për të zgjedhur udhëheqës dhe ekspertë me eksperiencë në punët administrative, arsimore dhe ekonomike.

J.J. SEDERHOLM

Shënim i përkthyesit

Shqipëria është në procesin përfundimtar të ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me Bashkimin Europian. Fotografia e mëposhtme ilustron më së miri entuziazmin e një çasti të shumë pritur për shqiptarët për t'u bërë pjesë e kontinentit të cilit i takojnë më shumë se askush tjetër. Kjo është fotografia e çastit kur u nënshkrua Marrëveshja për Hapjen e Negociatave për Stabilizim Asociimin e Shqipërisë në Bruksel, 12 Qershor 2006.

